

Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme për aktivet jo-financiare

(Ndryshimet në SNK 36)

Ndryshimet në SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve

Paragrafët 130 dhe 134 dhe titulli mbi paragrafin 138 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 140J. Teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është hequr viza mes përmes.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

130 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për një aktiv individual (duke përfshirë emrin e mirë) ose për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare, për të cilët është njohur ose anuluar një ~~çdo materiale~~ humbje nga zhvlerësimi gjatë periudhës për një aktiv individual, duke përfshirë emrin e mirë, ose për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare:

- (a) ...
 - (e) shumën e rikuperueshme të aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) dhe nëse shuma e rikuperueshme e aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është vlera e drejtë e tij minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit ose vlera e tij në përdorim.
 - (f) nëse shuma e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit, baza e përdorur për të matur vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit (në rastin kur vlera e drejtë është matur duke iu referuar një çmimi të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv identik). Një njësi ekonomike nuk i kërkohet të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga SNRF 13. njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
 - (i) nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë (shih SNRF 13), brenda së cilës matja e vlerës së drejtë të aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është kategorizuar në tërësinë e saj (pa marrë parasysh nëse 'kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit' janë të vëzhgueshme);
 - (ii) për matjet e vlerës së drejtë të kategorizuara brenda Nivelit 2 dhe Nivelit 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, një përshkrim i teknikës (teknikave) së vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Nëse ka pasur një ndryshim në teknikën e vlerësimit, njësia ekonomike do të japë informacion për këtë ndryshim dhe arsven (arsvet) pse e ka bërë atë; dhe
 - (iii) për matjet e vlerës së drejtë të kategorizuara brenda Nivelit 2 dhe Nivelit 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, çdo supozim kryesor mbi të cilin është bazuar drejtimi në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Supozimet kryesore janë ato për të cilat shuma e rikuperueshme e aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është më e ndjeshme. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese edhe për normën (normat) e skontimit të përdorura në matjen aktuale dhe në matjen e mëparshme, nëse vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit matet duke përdorur një teknikë të vlerës aktuale.
 - (g) ...
- ...

Vlerësimet që përdoren për të matur shumat e rikuperueshme të njërive gjeneruese të mjeteve monetare që përmbajnë emrin e mirë ose të aktiveve jo-materiale me jetë të dobishme të pafundme

134 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet e kërkuara nga (a) - (f) për çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësisish) për të cilat vlera kontabël neto e emrit të mirë ose e aktiveve jo-materiale me jetë të dobishme të papërcaktuar e shpërndarë në këtë njësi (grup njësisish) është e konsiderueshme në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të emrit të mirë ose të aktiveve jo-materiale me jetë të dobishme të pafundme:

- (a) ...
- (c) ~~shuma e rikuperueshme e njësisë (ose grupit të njësive)~~ dhe bazën mbi të cilën shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) është përcaktuar (p.sh. vlera në përdorim ose vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit).
- (d) ...
- ...

Dispozitat kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

138

...

140J Në maj 2013 paragrafët 130 dhe 134 dhe titulli mbi paragrafin 138 janë ndryshuar. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2014 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojë këto ndryshime në periudha (duke përfshirë periudhat krahasuese), në të cilat ajo nuk zbaton edhe SNRF 13.